



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 71, datë 27.07.2022

PËR
MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“RIKONSTRUKSION DHE SHITESË NË GODINËN E PEDIATRISË NË QSUT,
BASHKIA TIRANË”

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 40, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues zhvillues Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit të objektit: “Rikonstruksion dhe shtesë në godinën e Pediatriisë në QSUT, Bashkia Tiranë”, me subjekt zhvillues Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.
2. Afati i kryerjes së punimeve sipas këtij Vendimi, do të pasqyrohet në Dokumentin e Lejes së Ndërtimit, në përputhje me afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve bashkëlidhur Kontratës së Koncesionit të amenduar.
3. Harta e Planvendosjes së Strukturave miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 04, datë 27.02.219, nuk ndryshon.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTRIA E SHËNDEJTËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

OGERTA MANASTIRLIU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

